

LIGJI NR. 08/L-277

PËR SPORT

Kuvendi i Republikës së Kosovës:

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR SPORT

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për organizimin, zhvillimin dhe financimin e sportit dhe aktivitetit fizik në Republikën e Kosovës, në një ambient të sigurt, dhe promovimi i shëndetit dhe mirëqenies së sportistëve dhe shoqërisë në përgjithësi.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky ligj zbatohet nga të gjitha institucionet, organizatat dhe personat që përfshihen në veprimtarinë sportive dhe në aktivitetin fizik.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **Aktivitet fizik** – çdo lëvizje trupore e shkaktuar nga muskujt skeletorë që kërkon shpenzim të energjisë;

1.2. **Trajnim sportiv** – ndërmarrja e çfarëdoq procesi trajnues të sportistit, trajnerit, gjyqtarit dhe personave të tjerë të përfshirë në sport që ka për qëllim zhvillimin e karakteristikave antropologjike dhe aftësive motorike e funksionale, si dhe përvetësimi i aftësive motorike për një sport të caktuar ose degë sportive;

1.3. **Lojë tradicionale** – formë e aktivitetit fizik e cila ka karakter garues dhe zhvillohet në Republikën e Kosovës, në rajone të ndryshme të territorit të saj apo vetëm në një rajon, që për shkak të historisë së zhvillimit të lojës apo organizimit të garave për një kohë të gjatë dhe që është përcjellur në breza të ndryshëm, konsiderohet lojë tradicionale;

1.4. **Personi që kryen punë profesionale në sport** – trajneri, instruktori, personi zyrtar që organizon dhe udhëheq garë sportive dhe personat tjerë zyrtarë sipas akteve përkatëse të organizatave sportive;

1.5. **Rekreacion sportiv** – aktivitet fizik qoftë i planifikuar dhe programuar ose jo, që ka qëllim zhvillimin e aftësive psiko-fizike dhe shëndetit, pa pjesëmarrje në gara sportive zyrtare;

1.6. **Ndërmjetësim sportiv** – zhvillimi i aktivitetit të ndërmjetësimit ose përfaqësimit të sportistit apo trajnerit në marrëdhënien e tij të punës, si dhe aktiviteti i ndërmjetësimit apo përfaqësimit të klubit sportiv;

1.7. **Veprimtari sportive** – të gjitha format e veprimtarive fizike e sportive të tilla si pjesëmarrja në garë sportive, trajnimi sportiv, edukimi sportiv, ushtrimet sportive, organizimi dhe udhëheqja e garës sportive dhe ndërmjetësimi sportiv. Veprimtari sportive konsiderohet edhe organizimi i aktivitetit shkollor sportiv jashtëkurrikular, aktivitetit akademik sportiv, aktivitetit sportiv të punëtorëve, menaxhimi i infrastrukturës sportive dhe veprimtaritë e tjera administrative ose menaxheriale në kuadër të personave juridikë si pjesë e sportit.

2. Në kuptim të këtij ligji, emrat në njërën gjini nënkuptojnë edhe emrat në gjininë tjetër, pa diskriminim.

KAPITULLI II SPORTI, PARIMET DHE LLOJET E SPORTEVE

Neni 4 Sporti

1. Sporti përfshin të gjitha format e aktivitetit fizik qoftë në formë të organizuar ose jo, që synon ruajtjen ose përmirësimin e aftësisë fizike dhe mirëqenies mendore, krijimin e marrëdhënieve shoqërore, solidaritetit ose arritjen e rezultateve në gara të të gjitha niveleve.

2. Sporti është veprimtari e interesit të veçantë publik në Republikën e Kosovës.

3. Sporti zhvillohet në frymën e bashkëpunimit në mes të institucioneve të të gjitha niveleve, bashkëpunimit të tyre me organizatat sportive, dhe bashkëpunimit në mes të këtyre organizatave.

4. Qeveria e Republikës së Kosovës në bazë të propozimit të Ministrisë përgjegjëse për sport miraton Strategjinë Shtetërore për Sportin.

5. Të gjitha dokumentet e institucioneve publike të nivelit qendror dhe atij lokal, si dhe dokumentet strategjike të organizatave të sportit, përfshirë planet e punës, hartohen në përputhje me Strategjinë Shtetërore të Sportit.

Neni 5 Parimet e përgjithshme të sportit

1. Veprimet e institucioneve publike, organizatave sportive dhe të gjithë personave të përfshirë në sport bazohen në parimet e përgjithshme si në vijim:

1.1. **Sporti për të gjithë** – çdo person ka të drejtë të merret me sport, përfshirë aktivitetin fizik. Mekanizmat institucionalë dhe organizatat sportive promovojnë përfshirjen në sport;

1.2. **Ligjshmëria** - veprimet duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij ligji ose legjislationit tjetër përkatës në fuqi. Çdo kufizim ose ndalim i një të drejte në fushën e sportit duhet të bazohet në ligj ose aktet normative bazë të personit juridik që merr pjesë në veprimtari sportive;

1.3. **Qeverisja e mirë** - respektimi dhe zbatimi i Kodit të Qeverisjes së Mirë të përcaktuar me këtë ligj, respektimi i rregullave përkatëse etike dhe rregullave të tjera ndërkombëtare për qeverisjen e mirë;

1.4. **Mosdiskriminimi** – garantimi i pjesëmarrjes në veprimtari sportive dhe në qasje në infrastrukturë sportive në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e tjera përkatëse, si dhe ndalimi i diskriminimit në çfarëdo baze të përcaktuar me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi;

1.5. **Ambienti i sigurt dhe i favorshëm për të gjithë** - ambientet në të cilat zhvillohen veprimtaritë sportive duhet të jenë të sigurt, ku të gjithë personat e përfshirë në veprimtari sportive trajtohen me respekt, dinjitet dhe pa ngacmim si dhe në përputhje me standardet që mbrojnë shëndetin e tyre. Çdo dhunë, keqpërdorim, abuzim ose dukuri tjetër negative ndalohet dhe sanksionohet me ligj;

- 1.6. **Transparenca** - veprimet duhet të jenë transparente dhe dokumentet publike duhet të jenë të qasshme në përputhje me ligjin përkatës për qasjen në dokumente publike;
- 1.7. **Mbrojtja e privatësisë**—veprimet nuk cenojnë privatësinë dhe të dhënat personale të personave të përfshirë në aktivitet sportiv mbrohen në përputhje me ligjin përkatës;
- 1.8. **Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve**— ndërmarrja e të gjitha masave mbrojtëse për fëmijët dhe të rinjtë pjesëmarrës në sport, në të cilat përfshihen njoftimi i policisë, organit të kujdestarisë dhe organeve të tjera shtetërore përkatëse për çdo lloj dhune ndaj tyre, keqpërdorim, ngacmim ose sjellje tjetër të pahijshme;
- 1.9. **Mbrojtja e mjedisit dhe siguria publike** - ndërmarrja e të gjitha masave mbrojtëse për mjedisin, natyrën dhe kafshët gjatë zhvillimit të veprimtarisë sportive, në përputhje me legjisllacionin përkatës, si dhe moscenimi i sigurisë publike;
- 1.10. **Fair-play** – sporti zhvillohet në bazë të rregullave, konkurrencës së ndershme, respektit ndaj kundërshtarit, parandalimit dhe shmangies së dhunës dhe sjelljes jo të drejtë.

Neni 6

Llojet e sporteve të organizuara

1. Veprimtaritë sportive të organizuara në Kosovë sipas këtij ligji zhvillohen në çdo lloj sporti të njohur nga:
 - 1.1. Komiteti Olimpik Ndërkombëtar si sport olimpik ose sport joolimpik;
 - 1.2. asociacioni përkatës i federatave sportive ndërkombëtare;
 - 1.3. Komiteti Paralimpik Ndërkombëtar;
 - 1.4. Komiteti Ndërkombëtar i Sporteve të të Shurdhërve;
 - 1.5. Lëvizja Ndërkombëtare e Olimpiadës Speciale;
 - 1.6. sportet tjera që zhvillohen në Republikën e Kosovës dhe të njohura nga Ministria përgjegjëse për sport.
2. Veprimtaritë sportive sipas paragrafit 1 po ashtu zhvillohen në sportet elektronike
3. Kriter bazë për njohjen e sportit nga nënparagrafi 1.6 i paragrafit 1 të këtij neni është masiviteti i atij sporti në Republikën e Kosovës.
4. Procedura e njohjes së sporteve nga nënparagrafi 1.6 i paragrafit 1 i këtij neni përcaktohet me akt nënligjor sipas nenit 29 të këtij ligji.
5. Në rast të paqartësisë, Komiteti Olimpik i Kosovës respektivisht organizata tjetër përkatëse, ofron opinion për Ministrinë përgjegjëse për sport lidhur me klasifikimin e sportit sipas paragrafit 1, në përputhje me standardet e përcaktuara të autoritetit përgjegjës ndërkombëtar.
6. Aktiviteti fizik, aktivitetet rekreative sportive ose lojërat tradicionale, të cilat nuk kualifikohen si sport i organizuar sipas paragrafit 1 ose 2 të këtij neni, inkurajohen, promovohen dhe mund të mbështeten financiarisht nga buxheti i Republikës së Kosovës.

KAPITULLI III PJESËMARRËSIT NË SPORT

NËNKAPITULLI I PJESËMARRËSIT NË SPORT

Neni 7 Pjesëmarrësit në sport

1. Personat që marrin pjesë në veprimtari sportive janë personat fizikë dhe juridikë.
2. Personi fizik merr pjesë në veprimtari sportive në cilësinë e:
 - 2.1. sportistit;
 - 2.2. personit që kryen punë profesionale në sport; dhe
 - 2.3. agjentit sportiv.
3. Personat juridik që marrin pjesë në veprimtari sportive janë:
 - 3.1. Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK);
 - 3.2. Komiteti Paralimpik i Kosovës (KPK);
 - 3.3. federatat sportive;
 - 3.4. klubet sportive;
 - 3.5. federatat shumësportive;
 - 3.6. shkollat e sportit;
 - 3.7. qendrat e fitnesit dhe qendrat sportive; dhe
 - 3.8. shoqatat rekreative dhe shoqatat tjera.

NËNKAPITULLI II PERSONAT FIZIKË QË MARRIN PJESË NË SPORT

Neni 8 Sportisti

1. Sportisti mund të jetë profesional, amator, ose rekreativ.
2. Sportist profesional është çdo person i cili nga trajnimi dhe pjesëmarrja në garë sportive gjeneron të hyra financiare.
3. Sportist amator është çdo sportist tjetër që zhvillon trajnim dhe merr pjesë në garë sportive të federatave përkatëse.
4. Sportist rekreativ është çdo person tjetër që zhvillon aktivitet të rekreacionit sportiv siç përkufizohet me këtë ligj.

Neni 9 Trajneri dhe instruktori

1. Trajner është personi i cili përgatit dhe udhëheq sportistin në garë të sportit të organizuar.
2. Instruktor është personi i cili udhëzon zhvillimin e sportit dhe mësimin e teknikës së një sporti apo aktivitetit fizik, por që nuk ka qëllim trajnimin ose udhëheqjen e sportistit në garë sportive.

3. Përveç nëse me ligj të veçantë është përcaktuar ndryshe, profesionin e trajnerit mund ta ushtrojë çdo person i cili plotëson kushtet ligjore si në vijim:

3.1. ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare;

3.2. plotëson njërën nga këto kushte:

3.2.1. ka diplomë përkatëse universitare të edukimit fizik;

3.2.2. ka diplomë ose certifikatë të vlefshme për trajner në përputhje me nivelin përkatës të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, të lëshuar nga një institucion i akredituar nga agjencitë përkatëse në Republikën e Kosovës; ose

3.2.3. ka licensë për trajner të lëshuar nga një institucion i akredituar jashtë Republikës së Kosovës.

3.3. nuk e ka të ndaluar ushtrimin e veprimtarisë sportive sipas këtij ligji.

4. Përveç nëse me ligj të veçantë është përcaktuar ndryshe, profesionin e instruktorit mund ta ushtrojë çdo person i cili plotëson kushtet nga nënparagrafët 3.1 dhe 3.3 të këtij neni si dhe që ka:

4.1. diplomë përkatëse universitare të edukimit fizik;

4.2. diplomë ose certifikatë të vlefshme për instruktor në përputhje me nivelin përkatës të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, të lëshuar nga një institucion i akredituar nga agjencitë përkatëse në Republikën e Kosovës; ose

4.3. licensë për instruktor të lëshuar nga një institucion i akredituar jashtë Republikës së Kosovës.

5. Profesionin e instruktorit mund ta ushtrojë edhe personi i cili përmbush kushtet për të shërbyer si trajner sipas këtij ligji.

6. Për ushtrimin e veprimtarisë së trajnerit apo instruktorit, Federatat sportive mund të përcaktojnë kërkesa shtesë që lidhen me specifikat e sportit përkatës.

Neni 10

Personat zyrtarë që marrin pjesë në organizimin dhe udhëheqjen e garës sportive

1. Personat zyrtarë që marrin pjesë në organizimin dhe udhëheqjen e garës sportive janë: gjyqtari sportiv, delegati sportiv, komisioneri sportiv dhe personi tjetër që përcaktohet me akt normativ të federatës përkatëse.

2. Kushtet dhe mënyra e ushtrimit të veprimtarisë sportive e personave zyrtarë nga paragrafi 1 përcaktohen me akt normativ nga federata përkatëse.

3. Në sportet e organizuara në kuadër të Komitetit Paralimpik, Federatës së Sporteve të Shurdhërve të Kosovës dhe Olimpiadës Speciale, marrin pjesë personat zyrtarë të përcaktuar sipas rregullave të këtyre organizatave, në përputhje me rregullat e zbatueshme ndërkombëtare.

Neni 11

Agjenti sportiv

1. Agjenti sportiv është personi i cili zhvillon aktivitete të ndërmjetësimit sportiv dhe të përfaqësimit lidhur me transferimin e sportistit ose trajnerit nga një klub sportiv në një tjetër.

2. Ushtrimi i profesionit të agjentit sportiv rregullohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria përkatëse për Sport.

Neni 12

Vullnetarizmi në sport

1. Vullnetarizmi në sport është i rëndësishëm për zhvillimin e sportit në përgjithësi dhe inkurajimin e pjesëmarrjes në sport, përfshirë organizimin e ngjarjeve sportive.
2. Vullnetarizmi në sport promovohet dhe nga të gjitha organizatat e sportit. Ato kujdesen për rekrutimin, trajnimin dhe marrjen e masave të përshtatshme për sigurimin e pjesëmarrjes së vullnetarëve në sport.
3. Personave vullnetarë të angazhuar në organizatat e sportit ju njihet kontributi i veçantë dhe përvoja e punës vullnetare.

Neni 13

Kontrolli shëndetësor

1. Në trajnim dhe garë sportive të sportit të organizuar mund të marrë pjesë vetëm sportisti për të cilin është e vërtetuar aftësia shëndetësore.
2. Aftësia e sportistit vërtetohet në bazë të kontrollit shëndetësor, i cili duhet të ketë periudhë të caktuar të vlefshmërisë në përputhje me rregullat e federatës përkatëse ndërkombëtare duke u bazuar në statusin shëndetësor të sportistit, grupmoshën dhe nivelin garues.
3. Kontrolli shëndetësor sipas këtij neni bëhet nga institucionet e licencuara të nivelit sekondar apo terciar shëndetësor nga fusha e mjekësisë sportive. Federatat përkatëse kanë të drejtë të njohin kontrollin shëndetësor të sportistit të zhvilluar në një shtet tjetër.
4. Federata përkatëse mund të përcaktoj kritere shtesë për kontroll shëndetësor të sportistit në përputhje me paragrafin 1, në bazë të veçorive të sportit përkatës.
5. Federata përkatëse mund të përcaktoj rregulla për kontrollin shëndetësor të personave të tjerë profesionalë në sport.
6. Procedura e kontrollit shëndetësor të sportistëve përcaktohet dhe bazohet sipas protokollove klinike nga fusha e mjekësisë sportive dhe fushave tjera specialistike.

Neni 14

Kontrata e sportistit profesional

1. Kontrata në mes sportistit profesionist dhe klubit sportiv lidhet në formë të shkruar, noterizohet dhe regjistrohet në Federatën përkatëse sportive në përputhje me aktet normative të Federatës.
2. Kontrata nga paragrafi 1 lidhet në kohëzgjatje të caktuar prej më së shumti pesë (5) vjet dhe nuk parasheh periudhë provuese.
3. Kontrata nga paragrafi 1 përcakton pagën që e pranon sportisti për veprimtarinë sportive në kuadër të organizatës sportive dhe autoritetin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me zbatimin e kontratës. Paga, sipas këtij neni, nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar me ligjin përkatës në Republikën e Kosovës.
4. Shpërblimi për arritjen e rezultateve të larta sportive të klubit ose sportistit ose të ardhurat e tjera të përcaktuara me kontratë konsiderohen pjesë stimuluese mbi pagën bazë të cilën e pranon sportisti.
5. Sportisti nuk ka të drejtë të lidhë kontratë me më shumë se një klub sportiv në Republikën e Kosovës gjatë periudhës së njëjtë kohore.
6. Kontratat e përcaktuara në këtë nen mund të parashohin rregullim të veçantë nga legjislati i përkatës që rregullon marrëdhënien e punës, sipas marrëveshjes mes sportistit dhe organizatës

sportive, por duhet të përmbushin kriteret e caktuara me këtë nen si dhe kushtet e sigurisë dhe të shëndetit në punë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

7. Federatat përkatëse sportive mund të përcaktojnë rregulla shtesë për kontratat e sportistëve, si dhe kërkesa për lidhjen e kontratave sportive mes klubeve dhe sportistëve, për të garuar në nivele të caktuara të garave sportive.

Neni 15 **Bursa sportive shkollore**

1. Deri në moshën njëzetë e pesë (25) vjeçare sportisti mund të lidhë marrëveshje për bursë sportive shkollore me klubin sportiv.

2. Marrëveshja nga paragrafi 1 përfshin kompensimin për shpenzimet e nevojshme për shkollimin e sportistit dhe pjesëmarrjen në aktivitete sportive dhe pjesëmarrjen e sportistit në aktivitetet e klubit që ofron bursën duke përfshirë trajnimin dhe garën sportive.

Neni 16 **Kontratat e pjesëmarrësve të tjerë në sport**

Personat e tjerë që kryejnë punë profesionale në sport ushtrojnë veprimtarinë e tyre sportive në bazë të marrëveshjes me organizatën sportive, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të federatës përkatëse.

NËNKAPITULLI III **PERSONAT JURIDIKË QË MARRIN PJESË NË SPORT**

Neni 17 **Komiteti Olimpik i Kosovës**

1. Misioni i KOK është të zhvillojë, promovojë dhe mbrojë lëvizjen olimpike në Republikën e Kosovës në përputhje me Kartën Olimpikë.

2. KOK funksionon në formën e organizatës joqeveritare dhe ushtron aktivitetin në përputhje me këtë ligj, ligjin për OJQ, statutin dhe aktet normative të tij, si dhe rregullat përkatëse të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e veçanta të KOK janë:

3.1. Inkurajimi dhe promovimi i sportit me performancë të lartë dhe aktivitetit fizik, në Republikën e Kosovës;

3.2. propozimi dhe zbatimi i masave për përmirësimin dhe zhvillimin e sportit;

3.3. pjesëmarrja në hartimin dhe zbatimin e akteve të planifikimit strategjik të sportit;

3.4. koordinimi dhe monitorimi i aktiviteteve të anëtarëve të vet;

3.5. bashkëpunimi për zbatimin e aktiviteteve në terren për zhvillimin e sportit me organizatat e tjera sportive dhe institucionet përgjegjëse për sport;

3.6. mbështetja dhe promovimi i arritjeve kulminante sportive të sportistëve dhe pjesëmarrjes së tyre në ekipet shtetërore sportive në Lojërat Olimpikë, kampionatet dhe garat e tjera ndërkombëtare;

3.7. pjesëmarrja në vlerësimet e mbështetjes financiare për federatat, sportistët dhe trajnerët, që si proces udhëhiqet nga Agjencia e Sportit;

3.8. pjesëmarrja në zbatimin e aktiviteteve të rregullta në lidhje me zbatimin e rregullave dhe luftimin e dukurive negative dhe antidopingut në sport;

3.9. bashkëpunimi me federata për promovimin e punës profesionale në sport dhe kujdesi për aftësimin dhe zhvillimin e personave profesionalë në sport;

3.10. koordinimi i anëtarëve për përgatitjen e protokolleve, udhëzuesve dhe manualëve për çështje të ndryshme të rëndësishme për sportin;

3.11. ndërmarrja e veprimeve ndaj çdo forme të diskriminimit apo dhunës në sport;

3.12. promovimi dhe mbështetja e masave lidhur me përkujdesjen mjekësore dhe shëndetësore të sportistëve;

3.13. në rast të fillimit të procedurës së shpërbërjes së federatës sportive të caktuar ose pamundësisë së veprimit nga federata përkatëse sportive, vendos për marrjen përsipër të përfaqësueses shtetërore dhe kujdeset për mbrojtjen e interesave të sportistëve dhe të drejtave të fituara në nivel ndërkombëtar;

3.14. kryerja e detyrave të tjera të përcaktuara me këtë ligj, statutin dhe aktet e tjera normative të KOK.

Neni 18

Komiteti Paralimpik i Kosovës, Olimpiada Speciale dhe Federata e Sporteve e të Shurdhërve të Kosovës

1. KPK është organizatë e parasportit, e cila kujdeset për zhvillimin, promovimin dhe mbrojtjen e parasportit dhe lëvizjes paralimpike në Republikën e Kosovës në përputhje me Kartën Paralimpike.

2. Olimpiada Speciale e Kosovës është organizatë e sporteve të personave me aftësi të kufizuara intelektuale, e cila kujdeset për zhvillimin, promovimin dhe mbrojtjen e sporteve në këtë kategori, në përputhje me parimet dhe rregullat e Organizatës Ndërkombëtare të Olimpiadës Speciale.

3. Federata e Sporteve e të Shurdhërve të Kosovës (FSSHK) është organizatë e sportistëve të shurdhër që kujdeset për zhvillimin, promovimin dhe mbrojtjen e sporteve për të shurdhër, në përputhje me Kushtetutën e Komitetit Ndërkombëtar për Sportet e të Shurdhërve.

4. Organizatat nga ky nen funksionojnë në formën e organizatave joqeveritare dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me këtë ligj, ligjin për OJQ, statutin dhe aktet normative të tyre dhe rregullat përkatëse të organizatave ndërkombëtare në të cilat janë anëtare.

5. Detyrat dhe përgjegjësitë e veçanta të organizatave nga ky nen përcaktohen me këtë ligj, statutet dhe aktet tjera normative përkatëse të tyre.

Neni 19

Federata sportive

1. Për një sport të caktuar dhe të organizuar, për tërë territorin e Republikës së Kosovës, themelohet dhe vepron një federatë sportive në formën e organizatës jo-qeveritare.

2. Federata sportive përmban emrin Kosovë në emërtimin e saj si dhe e ka logon në përputhje me identitetin e Republikës së Kosovës dhe të sportit përkatës.

3. Anëtarë të federatës sportive janë klubet sportive të sportit të njëjtë dhe anëtarë të tjerë të përcaktuar me statutin e federatës.

4. Struktura organizative e federatës sportive duhet të ketë së paku organet qeverisëse me specifikat si në vijim:

4.1. Kuvendin e anëtarëve;

4.2. Bordin/Komiteti ekzekutiv;

- 4.2.1. së paku një anëtar i Bordit/Komitetit ekzekutiv duhet të jetë përfaqësues i sportistëve;
- 4.3. Komisionin mbikëqyrës;
- 4.4. mekanizmin disiplinor dhe atë për zgjidhje të ankesave; dhe
- 4.5. mekanizmin apo shoqatën përkatëse për përfaqësimin e sportistëve.
5. Anëtarësia e federatës është gjithëpërfshirëse, duke përfshirë aspektin gjinor dhe ofruar mundësinë për përfshirjen e komuniteteve joshumicë në Kosovë.
6. Për ushtrimin e veprimtarisë së saj, federata sportive miraton aktet e brendshme normative përkatëse, në përputhje me këtë ligj, ligjin për OJQ, legjislacionin tjetër në fuqi si dhe rregullat përkatëse të organizatave ndërkombëtare në të cilat janë anëtare.
7. Federatat sportive obligohen që të gjitha aktet e tyre normative t'i bëjnë publike në faqen e tyre zyrtare.
8. Dispozitat e këtij neni zbatohen përshtatshëmrisht edhe për federatat shumësportive dhe shoqatat sportive të punëtorëve.

Neni 20

Detyrat dhe përgjegjësitë e federatës sportive

1. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të federatës sportive janë:
 - 1.1. inkurajimi dhe promovimi i sportit përkatës dhe zhvillimit të qëndrueshëm në përputhje me objektivat strategjike;
 - 1.2. përcaktimi i sistemit, kushteve dhe mënyrës së organizimit të sportit garues në përputhje me parimet, rregullat dhe normat e përcaktuara nga federatat ndërkombëtare përkatëse të sportit;
 - 1.3. organizimi dhe zhvillimi i garave sportive;
 - 1.4. rregullimi i çështjeve që kanë të bëjnë me regjistrimin e sportistëve, statusin, të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, në përputhje me këtë ligj;
 - 1.5. vendosja për organizimin e garave ndërkombëtare me pjesëmarrje të klubeve dhe sportistëve të shteteve të tjera në Kosovë;
 - 1.6. vendosja lidhur me pjesëmarrjen e klubeve dhe sportistëve nga Kosova në gara sportive ndërkombëtare, në përputhje me parimin e meritokracisë dhe rregullat e përcaktuara nga federatat ndërkombëtare përkatëse;
 - 1.7. ofrimi i trajnimeve profesionale dhe licencimi i stafit profesional;
 - 1.8. menaxhimi i punëve profesionale dhe administrative lidhur me personat që zhvillojnë punë profesionale në sport;
 - 1.9. parandalimi dhe luftimi i dukurive negative në sport;
 - 1.10. ndërmarrja e masave disiplinore në përputhje me rregullat përkatëse;
 - 1.11. mbështetja për përfaqësuesen shtetërore të sportit;
 - 1.12. mbështetja për kujdesin mjekësor të sportistëve;
 - 1.13. bashkëpunimi me federatat ndërkombëtare sportive, me federatat tjera sportive dhe organizatat tjera të sportit;

1.14. konsultimi me Agjencinë e Sportit në procesin e përgatitjes së politikave dhe akteve normative të Federatës, për përputhshmërinë e tyre me këtë Ligj;

1.15. bashkëpunimi me institucionet përkatëse publike;

1.16. kryerja e detyrave të tjera të përcaktuara me statutin e federatës sportive.

Neni 21

Klubi sportiv

1. Klubi sportiv është person juridik, i cili zhvillon veprimtarinë sportive të trajnimit sportiv dhe pjesëmarrjes në garë sportive të sportit të organizuar.

2. Klubi sportiv regjistrohet dhe vepron si organizatë joqeveritare apo shoqëri tregtare, në përputhje me ligjet përkatëse.

3. Për të marrë pjesë në garë sportive, klubi sportiv regjistrohet në federatën përkatëse të sportit në përputhje me nenin 30.

4. Në cilësinë e shoqërisë tregtare klubi sportiv regjistrohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuara ose shoqëri aksionare.

5. Në emërtimin e tij klubi sportiv përmban fjalët "klubi sportiv" ose pas fjalës "klub" emrin e sportit në të cilin ushtron veprimtarinë.

6. Një klub nuk mund të ketë statusin e organizatës joqeveritare dhe të shoqërisë tregtare njëkohësisht.

7. Me përjashtim të organeve publike të Republikës së Kosovës, një person dhe anëtarët e familjes së tij të ngushtë që përfshijnë bashkëshortin, bashkëshortin jashtëmartesorë, prindërit dhe fëmijët, nuk mund të jenë pjesë e organeve qeverisëse e as të jenë aksionarë në vlerë prej më shumë se një (1) % të të gjithë kapitalit në dy ose më shumë klube të sportit të njëjtë.

8. Në fushën e menaxhimit apo si aksionar i klubit sportiv nuk mund të jetë personi i cili ushtron veprimtari të basteve sportive apo që e ka të ndaluar ushtrimin e veprimtarisë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

9. Ndryshimi i statusit juridik të klubit sportiv nga organizatë joqeveritare në shoqëri tregtare mund të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin përkatës për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

10. Ministria përgjegjëse për Sport me akt nënligjor rregullon kriteret sportive dhe procedurën përkatëse për ndryshimin e statusit juridik të klubeve.

Neni 22

Federata e Sportit Shkollor e Kosovës dhe Federata e Sportit Universitar e Kosovës

1. Federata e Sportit Shkollor e Kosovës është federatë shumësportive, e cila funksionon në formën e organizatës jo-qeveritare dhe kujdeset për zhvillimin, promovimin dhe mbrojtjen e sportit në shkolla të nivelit të arsimit parauniversitar.

2. Federata e Sportit Shkollor e Kosovës zhvillon veprimtarinë në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror.

3. Federata e Sportit Universitar e Kosovës është federatë shumësportive, e cila funksionon në formën e organizatës jo qeveritare dhe kujdeset për zhvillimin, promovimin dhe mbrojtjen e sportit në institucione të nivelit të arsimit të lartë.

4. Anëtarë të Federatës së Sportit Shkollor të Kosovës janë shoqatat e sportit shkollor në nivel të komunës, ndërsa anëtarë të Federatës së Sportit Universitar të Kosovës janë shoqatat përkatëse që

përfaqësojnë institucionet e arsimit të lartë. Këto federata me statut të tyre mund të përfshijnë edhe anëtarë të tjerë.

5. Anëtarë të shoqatës së sportit shkollor në nivel të komunës janë institucionet arsimore parauniversitare në atë komunë, që përfaqësohen nga pedagogët e edukimit fizik të institucionit.

6. Strukturat organizative të Federatës së Sportit Shkollor dhe Federatës së Sportit Universitar duhet të kenë së paku organet qeverisëse të përcaktuara me paragrafin 4 të nenit 19 të këtij ligji.

7. Federata e Sportit Shkollor mbështet organizimin e garave shkollore në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror dhe mundëson përfaqësimin e sportistëve të shkollave në nivel ndërkombëtar.

8. Federata e Sportit Universitar organizon garat në nivel të universiteteve dhe kolegjeve dhe mundëson përfaqësimin e sportistëve të universiteteve në nivel ndërkombëtar.

9. Detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të veçanta të federatave përcaktohen me aktet e brendshme normative përkatëse, në përputhje me këtë ligj, ligjin për OJQ, legjislacionin tjetër në fuqi si dhe rregullat përkatëse të organizatave ndërkombëtare në të cilat janë anëtare.

10. Për realizimin e aktiviteteve sportive, federatat nga ky nen bashkëpunojnë me federatat e sporteve përkatëse.

11. Nxënësit dhe studentët të cilët zhvillojnë aktivitete sportive në kuadër të institucioneve përkatëse, kanë përparësi për shfrytëzimin e infrastrukturës sportive shkollore dhe universitare në raport me shfrytëzuesit e jashtëm të kësaj infrastrukture.

Neni 23 **Shoqatat Sportive të Punëtorëve**

1. Shoqatat Sportive të Punëtorëve në Kosovë janë shoqata shumësportive, të cilat funksionojnë në formën e organizatës jo-qeveritare dhe kujdesen për zhvillimin, promovimin dhe mbrojtjen e sportit të punëtorët e institucioneve publike dhe/ose organizatave private që veprojnë në Republikën e Kosovës.

2. Anëtarë të shoqatave nga paragrafi 1 mund të jenë përfaqësuesit e institucioneve publike, përfaqësuesit e organizatave private të regjistruara në organet kompetente përkatëse, sindikatat e punëtorëve dhe anëtarë të tjerë të përcaktuar me statutin e shoqatës përkatëse.

3. Struktura organizative e shoqatave nga paragrafi 1 duhet të ketë së paku organet qeverisëse të përcaktuara në paragrafin 4 të nenit 19 të këtij ligji.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të veçanta të shoqatave përcaktohen me aktet e brendshme normative përkatëse, në përputhje me këtë ligj, ligjin për OJQ, legjislacionin tjetër në fuqi si dhe rregullat përkatëse të organizatave ndërkombëtare në të cilat janë anëtare.

Neni 24 **Shkolla e sportit**

1. Shkolla e sportit është person juridik që zhvillon veprimtarinë sportive të trajnimit ose dhënies së instruksioneve sportive për sportistët nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare.

2. Shkolla e sportit regjistrohet dhe vepron si shoqëri tregtare në përputhje me ligjin përkatës.

3. Në emërtimin e saj, shkolla e sportit përmban fjalët "shkollë e sportit" ose pas fjalës "shkollë" emrin e sportit në të cilin ushtron veprimtarinë.

4. Paragrafi 2 i këtij neni nuk zbatohet për shkollat e sportit që funksionojnë në kuadër të klubeve sportive.

5. Shkolla e sportit duhet të ketë në dispozicion infrastrukturën përkatëse, pajisjet e përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë sportive dhe trajnerin ose instruktorin përkatës.

6. Ushtrimin e veprimtarisë sportive të shkollës së sportit e lejon dhe mbikëqyr Federata e sportit përkatës sipas veprimtarisë së shkollës së sportit.

7. Procedura dhe kushtet për zbatimin e paragrafit 6 të këtij neni, përfshirë pezullimin dhe revokimin e lejimit, përcaktohet me akt normativ të Federatës së sportit përkatës.

Neni 25

Qendra e fitnesit dhe qendra sportive

1. Qendra e fitnesit është organizatë e sportit, në kuadër të ambientit të së cilës, personi fizik udhëzohet dhe zhvillon aktivitet fizik.

2. Qendra sportive është organizatë e sportit, në kuadër të ambientit të së cilës, personi fizik udhëzohet rreth zhvillimit të veprimtarisë sportive dhe mësimi të teknikës së një ose më shumë sporteve të caktuara.

3. Organizatat nga paragrafi 1 dhe 2 regjistrohen dhe veprojnë si shoqëri tregtare, në përputhje me ligjin përkatës.

4. Organizatat nga paragrafi 1 dhe 2 duhet të ketë në dispozicion infrastrukturën përkatëse, pajisjet e përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë dhe instruktorin përkatës.

5. Ushtrimin e veprimtarisë të organizatave nga paragrafi 1 dhe 2 e lejon Agjencia e Sportit.

6. Procedura dhe kushtet për zbatimin e paragrafit 5, përfshirë pezullimin dhe revokimin e lejimit, përcaktohet me akt normativ të Ministrisë përgjegjëse për Sport.

Neni 26

Shoqata rekreative

Shoqata rekreative është organizim nga personat fizikë që zhvillojnë aktivitete rekreative, lojëra tradicionale ose çdo formë tjetër të aktivitetit fizik.

Neni 27

Organizimet për mbrojtjen dhe avokimin për të drejtat e sportistëve dhe personave të përfshirë në sport

1. Në Republikën e Kosovës veprojnë shoqatat e sportistëve, shoqatat e trajnerëve dhe shoqatat e personave të tjerë të përfshirë në sport, të cilat mbrojnë dhe avokojnë për drejtat e anëtarëve të tyre pranë organizatave, federatave, klubeve apo autoriteteve të tjera përkatëse.

2. Shoqatat nga paragrafi 1 veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në përputhje me Ligjin për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare

Neni 28

Kodi i Qeverisjes së Mirë

Për të gjitha organizatat sportive zbatohet Kodi i Qeverisjes së Mirë i miratuar nga Ministri përgjegjës për Sport, pas konsultimit me organizatat e sportit

KAPITULLI IV REGJISTRIMI I FEDERATAVE DHE KLUBEVE SPORTIVE

Neni 29

Regjistrimi i federatës sportive dhe lejimi i ushtrimit të veprimtarisë

1. Federata e sportit përkatës themelohet dhe regjistrohet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare dhe këtij ligji.
2. Aplikanti për regjistrimin e federatës së sportit përkatës sipas paragrafit 1 të këtij neni, me qëllim të përdorimit të ligjshëm të emrit “Federatë” në emrin e organizatës dhe me qëllim të përfaqësimit dhe organizimit zyrtar të garave vendore e nderkombëtare, si dhe përfitimit të fondeve nga institucionet publike plotëson kriteret bazë sportive në vijim, tek Agjencia për Sport:
 - 2.1. marrëveshjen e së paku pesë (5) klubeve sportive aktive në sportin e njëjtë të caktuar, ku dy (2) prej tyre janë themeluar dhe funksionojnë së paku për dy (2) vite para paraqitjes së kërkesës për themelimin dhe regjistrimin e federatës;
 - 2.2. posedimin e aktit normativ themelues për federatën, të harmonizuar me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet ndërkombëtare të federatës sportive të njëjtë, nëse e njëjta ekziston;
 - 2.3. themeluesit dhe përfaqësuesi i autorizuar të mos e kenë të ndaluar ushtrimin e veprimtarisë sipas dispozitave të këtij ligji; dhe
 - 2.4. listën me numrin e sportistëve, trajnerëve dhe gjyqtarëve aktivë të saj.
3. Agjencia për Sport, pas vlerësimit të përmbushjes së kriterëve sportive nga paragrafi 2 i këtij neni, nxjerr vendim për lejimin e kushtëzuar me të cilin vërteton se aplikanti për regjistrimin e Federatës së sportit përkatës i përmbush kriteret sportive për të fituar të drejtën e përdorimit të emrit “Federatë” e sportit përkatës në emrin zyrtar të organizatës.
4. Në rast të refuzimit të lejimit të kushtëzuar, aplikanti ka të drejtë të paraqes ankesë në Ministrinë përgjegjëse për sport.
5. Vendimi i Agjencisë për Sport nga paragrafi 3 i këtij neni, bëhet pjesë e dokumentacionit për regjistrim të federatës në ministrinë përgjegjëse për regjistrimin e OJQ-ve.
6. Lejimi për ushtrimin e veprimtarisë bëhet i vlefshëm nga momenti kur Federata regjistrohet në ministrinë përgjegjëse për regjistrimin e OJQ-ve.
7. Brenda periudhës një (1) vjeçare të lejimit të ushtrimit të veprimtarisë sipas dispozitave përkatëse të këtij ligji, Federata duhet të dëshmoj tek Agjencia plotësimin e kushteve nga neni 19 i këtij ligji.
8. Procedura e lejimit të ushtrimit të veprimtarisë së federatës sportive nga Agjencia për Sport, përfshirë procedurën e pezullimit dhe revokimit të lejimit, si dhe çështjet e tjera me rëndësi, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrisë përgjegjëse për Sport.
9. Ky nen zbatohet përshtatshëmrisht edhe për Federatën e Sportit Shkollor të Kosovës, Federatën e Sportit Universitar të Kosovës dhe shoqatat sportive të punëtorëve.

Neni 30

Regjistrimi i klubeve sportive

1. Klubi sportiv fillimisht regjistrohet në Ministrinë përgjegjëse për punë të brendshme në rast se vepron si organizatë joqeveritare apo në Ministrinë përgjegjëse të tregtisë në rast se vepron si shoqëri tregtare, në përputhje me dispozitat e ligjeve përkatëse.
2. Për të marrë pjesë në garë sportive të organizuar klubi sportiv regjistrohet në federatën sportive përkatëse.

3. Kushtet për regjistrim të klubit në federatë sportive janë:

- 3.1. statuti dhe aktet e tjera normative për themelimin e klubit sportiv të miratuara;
- 3.2. strukturat qeverisëse të themeluara dhe personat që angazhohen në organet drejtuese të mos e kenë të ndaluar të ushtrojnë këtë veprimtari sipas këtij ligji;
- 3.3. vendimi i komunës me të cilin dëshmohet selia e klubit ku ushtron veprimtarinë sportive bazë të tij;
- 3.4. posedimi i infrastrukturës optimale për ushtrimin e veprimtarisë sportive të klubit, që vërtetohet nga menaxheri i infrastrukturës përkatëse;
- 3.5. lista e sportistëve që janë pjesë e klubit dhe trajnerin e angazhuar që plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 9.

4. Federata përkatëse sportive miraton aktin normativ përkatës për regjistrimin e klubeve sportive në përputhje me këtë nen, ku mund të përcaktojë kushte shtesë nga ato të vendosura në paragrafin 3 të këtij neni. Federata përmes aktit normativ rregullon edhe pezullimin dhe revokimin e regjistrimit të klubeve.

5. Klubi sportiv mban së paku një herë në vit mbledhjen e Kuvendit në të cilën shqyrtohet raporti financiar si dhe plani i punës për vitin aktual si dhe për çdo ndryshim në strukturën e klubit njoftohet federata përkatëse.

Neni 31

Pezullimi dhe revokimi i lejimit të ushtrimit të veprimtarisë së federatës së sportit përkatës

1. Pezullimi i lejes së Federatës së sportit përkatës bëhet kur:

- 1.1. leja është siguruar në bazë të dokumenteve të falsifikuara apo informacionit tjetër jo të vërtetë;
- 1.2. themeluesit dhe përfaqësuesit e strukturave qeverisëse ushtrojnë veprimtari për qëllime tjera nga ato që janë përcaktuar në aktin e themelimit;
- 1.3. dështon vazhdimisht të raportojë për fondet e pranuar publike, dhe dështon vazhdimisht në procesin e nënshtrimit të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të auditimit të menaxhimit të parasë publike;
- 1.4. shkelen dispozitat e këtij ligji të cilat pamundësojnë zhvillimin e sportit të caktuar.

2. Pezullimi ka karakter të përkohshëm, ku federatës së sportit përkatës i ofrohet mundësia për të përmirësuar shkëlqen e konstatuar nga paragrafi 1 i këtij neni, në afatin e përcaktuar.

3. Në rast të mosveprimit sipas udhëzimeve nga Agjencia e Sportit, federatës së sportit përkatës i revokohet leja.

4. Agjencia e Sportit është përgjegjëse për pezullimin dhe revokimin e lejes së federatës sipas detyrës zyrtare apo në bazë të propozimit të Inspektoratit për Sport.

5. Kundër vendimit të Agjencisë nga paragrafi 4 i këtij neni, pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë në Ministrinë përgjegjëse për Sport.

6. Ky nen zbatohet përshtatshëmrisht edhe për Federatën e Sportit Shkollor të Kosovës, Federatën e Sportit Universitar të Kosovës dhe shoqatat sportive të punëtorëve.

7. Ministria përgjegjëse për sport me akt nënligjor të nxjerrë sipas nenit 29, paragrafi 8, përcakton procedurën për pezullimin dhe revokimin e lejes së federatës sportive.

KAPITULLI V ZHVILLIMI I SPORTIT GARUES

Neni 32 Garat sportive

1. Gara sportive është një garë e organizuar e klubeve sportive ose e sportistëve individualë që organizohet dhe drejtohet nga një person juridik i autorizuar për organizimin dhe menaxhimin e një gare sportive.
2. Gara sportive e organizuar nga federatat sportive ose anëtarët e tyre zhvillohet në përputhje me aktet përkatëse të federatës sportive që përcaktojnë elementet bazë të sistemit të garave në kategori të ndryshme të moshave dhe në rang garash qoftë në atë të nivelit lokal, rajonal apo shtetëror.
3. Organizatori i drejtpërdrejtë i garës sportive është i detyruar të ofrojë siguri për pjesëmarrësit në garë dhe publikun, si dhe ndihmë mjekësore përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 33 Garat sportive ndërkombëtare

1. Gara sportive ndërkombëtare në Republikën e Kosovës organizohet në përputhje me këtë ligj si dhe kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga federata ndërkombëtare e sportit përkatës.
2. Propozimi i kandidaturës për organizimin e garës ndërkombëtare shumëdisiplinare bëhet nga KOK, kurse për kampionatet dhe kupat botërore dhe evropiane në sporte të caktuara bëhet nga federata përkatëse e sportit të caktuar.
3. KOK, Olimpiada Speciale ose FSSHK propozojnë kandidaturën për mbajtjen e garës ndërkombëtare shumëdisiplinare përkatëse.
4. Federata e Sportit Shkollor ose Federata e Sportit Universitar propozojnë kandidaturën për mbajtjen e garës ndërkombëtare shkollore gjegjësisht universitare.
5. Iniciativa për kandidim bëhet në koordinim të ngushtë me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe institucionet e tjera përkatëse për çështjet që kanë të bëjnë me financimin, infrastrukturën, sigurinë dhe elemente të tjera të rëndësishme për organizimin e garës.

Neni 34 Pjesëmarrja e shtetasve të huaj në gara sportive dhe natyralizimi i tyre

1. Shtetasi i huaj mund të marrë pjesë në garë sportive në Republikën e Kosovës apo të regjistrohet si lojtar i huaj në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga federata vendore përkatëse sportive dhe në përputhje me ligjin përkatës që rregullon qëndrimin dhe punën e të huajve në Republikën e Kosovës.
2. Me kërkesë të federatës përkatëse dhe sipas rekomandimit të KOK, ose KPK për parasportistët, Presidentit të Republikës së Kosovës mund t'i propozohet që një sportisti që është shtetas i huaj t'i jepet shtetësia e Kosovës, me qëllim që i njëjti të bëhet pjesë e përfaqësueses shtetërore të sportit përkatës.

KAPITULLI VI MEKANIZMAT INSTITUCIONALE

Neni 35 Ministria përgjegjëse për Sport

1. Ministria përgjegjëse për Sport është institucioni kryesor i Qeverisë së Kosovës në fushën e sportit dhe ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

- 1.1. përgatit politikat publike për sportin dhe aktivitetin fizik;
- 1.2. propozon dhe harton aktet ligjore, harton dhe miraton aktet nënligjore dhe përcakton standardet në fushën e sportit në përputhje me këtë ligj;
- 1.3. zhvillon infrastrukturën e sportit;
- 1.4. bashkëpunon me të gjitha institucionet dhe organizatat e sportit për zhvillimin e sportit në Republikën e Kosovës, duke respektuar pavarësinë e funksionimit të tyre;
- 1.5. zhvillon aspektet e diplomacisë sportive në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për Punë të Jashtme;
- 1.6. kryen detyra të tjera në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 36 **Agjencia e Sportit**

1. Agjencia e Sportit është agjenci ekzekutive e cila themelohet me këtë ligj në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për Sport. Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë janë si në vijim:

- 1.1. promovon dhe zhvillon sportin në bashkëpunim me organizatat e sportit, federatat sportive, federatat dhe shoqatat shumësportive dhe pjesëmarrësit tjerë në sport;
- 1.2. zhvillon procedurën administrative të lejimit të ushtrimit të veprimtarisë të federatave sportive, dhe organizatave tjera në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- 1.3. ofron mbështetje financiare për sportin e organizuar dhe aktivitetin fizik;
- 1.4. monitoron rregullisht zbatimin e Strategjisë së Sportit si dhe raporton në Ministrinë përgjegjëse për Sport dhe autoritetet e tjera përkatëse për progresin e arritur;
- 1.5. promovon, mbështet, zbaton dhe koordinon zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore përkatëse;
- 1.6. menaxhon Regjistrin Shtetëror të Sportit;
- 1.7. mbledh, analizon dhe publikon rregullisht të dhënat për fushën e sportit;
- 1.8. lëshon lejen e federatave sportive për zhvillimin e veprimtarisë së tyre në territorin e Republikës së Kosovës;
- 1.9. bashkëpunon me të gjitha institucionet e nivelit qendror dhe lokal, organizatat sportive dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile, të cilat kanë fushëveprim sportin;
- 1.10. propozon miratimin e kodit të qeverisjes së mirë;
- 1.11. nxjerr protokollin për pjesëmarrje ndërkombëtare në garat sportive, në bashkëpunim me organizatat sportive;
- 1.12. nxjerr udhëzime për unifikimin e metodologjisë së zhvillimit të politikave për organizatat e sportit, federatat dhe shoqatat shumësportive, federatat sportive dhe anëtarëve të dhe tyre; dhe
- 1.13. kryen detyra të tjera në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2. Agjencia e Sportit udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv. Emërimi, shkarkimi, funksionet dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv rregullohen me dispozitat përkatëse në fuqi për zyrtarët publikë në Republikën e Kosovës.

3. Organizimi i brendshëm i Agjencisë së Sportit rregullohet me akt nënligjor të propozuar nga Ministri përgjegjës për Sport dhe të miratuar nga Kryeministri.

4. Mjetet financiare për veprimtarinë e Agjencisë sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës. Për realizimin e mandatit të promovimit dhe zhvillimit të sportit Agjencia mund të pranojë fonde të tjera, të cilat në asnjë mënyrë nuk duhet të ndikojnë në pavarësinë vendimmarrëse dhe financiare të saj. Fondet e pranura bëhen publike në faqen zyrtare të Agjencisë.

Neni 37 **Inspektorati i Sportit**

1. Inspektorati i Sportit është agjenci ekzekutive, e cila themelohet me këtë ligj dhe vepron në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për Sport.

2. Inspektorati i Sportit udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv. Emërimi, shkarkimi, funksionet dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv rregullohen me dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi për zyrtarët publikë në Republikën e Kosovës.

3. Organizimi i brendshëm i Inspektoratit të Sportit rregullohet me akt nënligjor të propozuar nga Ministri përgjegjës për Sport dhe të miratuar nga Kryeministri.

4. Mjetet financiare për veprimtarinë e Inspektoratit sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Neni 38 **Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Inspektoratit të Sportit**

1. Inspektorati i Sportit është përgjegjës për kryerjen e inspektimeve për të gjithë pjesëmarrësit në sport, përfshirë njësitë përkatëse të mekanizmave institucionalë.

2. Inspektorati i Sportit kryen inspektimet që kanë të bëjnë me:

2.1. përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga ky ligj dhe legjislacionit në fuqi i ndërlidhur me sportin;

2.2. infrastrukturën sportive;

2.3. mirëmbajtjen dhe zbatimin e Regjistrit Shtetëror të Sportit;

2.4. harmonizimin e akteve normative të organizatave të sportit me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi;

2.5. pengesat për personat të cilëve i ndalohet pjesëmarrja në sport sipas dispozitave përkatëse të këtij ligji;

2.6. përmbushjen e detyrimeve për ushtrimin e veprimtarisë në sport përfshirë përmbushjen e kushteve ligjore të kualifikimeve për trajner dhe instruktor;

2.7. zbatimin e kushteve të parapara teknike dhe shëndetësore për të siguruar një ambient të sigurtë të zhvillimit të sportit;

2.8. inspektime tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

3. Për zbatimin e këtij ligji, inspektorati ka të drejtën e nxjerrjes së rekomandimeve për ndërmarrjen e veprimeve për evitimin e shkeljeve të caktuara, shqiptimin e gjobave dhe propozimin për pezullimin dhe ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë në përputhje me këtë ligj.

4. Nëse gjatë inspektimit vërehet se autoriteti që inspektohet bënë shkelje të dispozitave të ligjit për të cilat janë në kompetencë të organit tjetër inspektues, Inspektorati i Sportit e raporton shkeljen në inspektoratin kompetent.

5. Kundër vendimeve të Inspektoratit të Sportit, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Ministrinë përgjegjëse për Sport. Ankesa zgjidhet nga një komision profesional prej pesë (5) anëtarë i krijuar nga Ministria.

6. Inspektorati i Sportit zhvillon dhe miraton udhëzues për vlerësimin e rrezikut, planifikimin dhe koordinimin e inspektimeve, dokumentimin e aktiviteteve inspektuese dhe raportimin për sektorin e sportit në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 39 **Këshilli Shtetëror për Sport**

1. Këshilli Shtetëror për Sport është organ këshillues me ekspertizë profesionale në fushën e sportit, i cili diskuton çështje të rëndësishme për sportin dhe ofron rekomandime për Ministrin përgjegjës për Sport.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Shtetëror për Sport janë:

2.1. propozimi i masave për përmirësimin dhe zhvillimin e sportit në Republikën e Kosovës;

2.2. diskutimi dhe ofrimi i rekomandimeve lidhur me politikat dhe legjislacionin në fushën e sportit apo të ndërlidhur me sportin;

2.3. organizimi i tryezave të diskutimit mes organizatave sportive, federatave sportive, federatave dhe shoqatave shumësportive dhe mekanizmave institucionalë të sportit dhe propozimi i masave koordinuese përkatëse;

2.4. vlerësimi i propozimeve dhe rekomandimi i dhënies së çmimeve sportive, në përputhje me këtë ligj; dhe

2.5. detyra dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara me rregulloren përkatëse të Këshillit Shtetëror për Sport.

3. Këshilli Shtetëror për Sport përbëhet nga Ministri përgjegjës për Sport dhe tetë (8) anëtarë ekspertë të emëruar nga Ministri.

4. Tre (3) nga anëtarët e Këshillit nominohen nga autoritetet si në vijim:

4.1. një (1) anëtar nominohet nga Agjencia e Sportit;

4.2. një (1) anëtar nominohet nga KOK;

4.3. një (1) anëtar nominohet nga KPK, Olimpiada Speciale e Kosovës dhe FSSHK sipas rotacionit;

5. Pesë (5) anëtarët e tjerë në Këshill emërohen drejtpërdrejt nga Ministri përgjegjës për Sport, prej të cilëve:

5.1. një (1) nga radhët e profesorëve universitar të edukimit sportiv;

5.2. një (1) nga radhët e organizatave të shoqërisë civile në fushën e sportit;

5.3. një (1) anëtar nga radhët e sportistëve aktiv profesional në Kosovë;

5.4. një (1) anëtar nga radhët e trajnerëve aktiv në Kosovë; dhe

5.5. një (1) nga radhët e personaliteteve të shquara të sportit në Kosovë.

6. Ministria përgjegjëse për Sport ofron përkrahje logjistike dhe financiare për mbarëvajtjen e punës së Këshillit.

7. Këshilli mban mbledhjet e tij së paku katër (4) herë në vit.

8. Mandati i anëtarit të Këshillit është tre (3) vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

9. Ministri përgjegjës për sport me akt nënligjor përcakton organizimin, funksionimin, mënyrën e punës dhe kompensimin financiar për Këshillin Shtetëror për Sport.

Neni 40 **Agjencia Antidoping**

Agjencia Antidoping funksionon në përputhje me ligjin përkatës për antidoping dhe ka për qëllim luftimin ndaj përdorimit të substancave dhe metodave të dopingut në sport, për të mbrojtur shëndetin e sportistëve, për të garantuar drejtësi dhe mundësi të barabarta në garat sportive dhe për të ruajtur integritetin e sportit, në përputhje me konventat, standardet dhe praktikatat e antidopingut.

Neni 41 **Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive**

1. Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive funksionon në përputhje me legjislacionin përkatës për shëndetësi dhe ka rol kyç në kujdesin shëndetësor të sportistëve si dhe parandalimin dhe trajtimin e lëndimeve potenciale sportive.

2. Qendra mbështetet dhe financohet nga Ministria përgjegjëse e Shëndetësisë dhe Ministria Përgjegjëse për Sport.

Neni 42 **Instituti për Kërkime Shkencore në Fushën e Sportit**

Instituti për Kërkime Shkencore në Fushën e Sportit themelohet në përputhje me legjislacionin përkatës në Republikën e Kosovës.

Neni 43 **Këshilli kundër dukurive negative në sport**

Këshilli kundër dukurive negative në sport funksionon në përputhje me ligjin e veçantë.

Neni 44 **Komuna**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e komunës në fushën e sportit janë si në vijim:

1.1. promovon zhvillimin e sportit dhe aktivitetit fizik në nivel të komunës;

1.2. përgatit dhe zbaton dokumente të brendshme të politikave dhe plane të veprimit në përputhje me Strategjinë e Sportit;

1.3. miraton dhe zbaton akte normative në nivel të komunës për fushën e sportit;

1.4. mbështet financiarisht sportistët, profesionistët e sportit, klubet dhe personat e tjerë të përfshirë në sport në komunën përkatëse;

1.5. zhvillon dhe menaxhon infrastrukturën sportive në nivel të komunës në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

1.6. kujdeset për zhvillimin e sportit shkollor në bashkëpunim me institucionet e arsimit dhe Federatën e Sportit Shkollor të Kosovës;

1.7. ndan çmime sportive në nivel të komunës;

1.8.bashkëpunon me organizatat sportive, federatat sportive, federatat dhe shoqatat shumësportive dhe mekanizmat e tjerë institucionalë në fushën e sportit;

1.9.kryen edhe detyra të tjera që i caktohen komunës me legjislacionin përkatës në fuqi.

KAPITULLI VII FINANCIMI I SPORTIT DHE ÇMIMET SPORTIVE

Neni 45 Bazat e financimit të sportit

1. Mjetet për financimin e sportit në nivel qendror dhe lokal sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe instrumentet tjera të financimit.

2. Financimi i sportit sigurohet edhe nga:

2.1. Kryerja e aktiviteteve sportive;

2.2. Anëtarësimet përkatëse;

2.3. Sponsorizimet dhe donacionet;

2.4. Fondet dhe instrumentet ekonomike me të cilat institucionet publike financojnë sportin;

2.5. Realizimi i aktiviteteve ekonomike;

2.6. Të hyrat nga instrumentet ekonomike të përcaktuara nga legjislacioni tatimor;

2.7. Granti specifik i përcaktuar me legjislacionin përkatës për financat e pushtetit lokal;

2.8. Mjetet tjera financiare të fituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Të hyrat që krijohen nga parashikimi i ligjit për sport derdhen në buxhetin e shtetit dhe ndahen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 46 Financimi për funksionim dhe performancë

1. Financimi për funksionim vjetor të KOK, KPK, Olimpiadës Speciale dhe FSSHK, sigurohet nga buxheti i Republikës së Kosovës.

2. Federatat sportive, federatat shumësportive dhe shoqatat sportive të punëtorëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me lejen përkatëse nga Agjencia për Sport, pranojnë financim për funksionim dhe operim vjetor, si dhe financim shtesë bazuar në performancës e tyre për vitin paraprak.

3. Procesi i financimit nga ky Nen udhëheqet dhe zbatohet nga Agjencia e Sportit.

4. Procedura dhe kushtet për financim nga ky nen përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozim të Ministrisë përgjegjëse për Sport.

Neni 47 Stimulimi financiar për arritjen e rezultateve sportive, shpërblimet financiare dhe kompensimi i përhershëm financiar

1. Sportistët dhe trajnerët me potencial për arritjen e rezultateve kulminante sportive në lojërat olimpike, paralimpike, garën e nivelit botëror ose evropian, financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës për periudhë të caktuar kohore në drejtim të arritjes së këtyre rezultateve.

2. Sportistët dhe trajnerët që arrijnë rezultate sportive kulminante në lojërat olimpike, lojërat paralimpike, garën e nivelit botëror ose evropian, ju takon shpërblim i caktuar financiar.

3. Të drejtën për kompensim të përhershëm financiar e ka sportisti që duke përfaqësuar Republikën e Kosovës ka fituar medalje olimpike, paralimpike, medalje në garën e nivelit botëror ose evropian.
4. E drejta për kompensim të përhershëm financiar fitohet vetëm për arritjen më të lartë të sportistit në sportin përkatës.
5. Vlera e kompensimit të përhershëm financiar nga ky nen ofrohet në baza mujore dhe caktohet nga Ministri përgjegjës për Sport. Vlera e kompensimit rishikohet në përputhje me faktorët ekonomikë.
6. Procesi i financimit nga ky nen udhëheqet dhe zbatohet nga Agjencia e Sportit.
7. Procedura dhe kushtet për zbatimin e financimit nga ky nen përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministri përgjegjës për Sport.

Neni 48 **Financimi nga Komuna**

Klubet sportive, sportistët dhe trajnerët financohen nga buxheti i Komunës ku ato ushtrojnë veprimtarinë sportive, në përputhje me procedurën dhe kushtet e përcaktuara me Rregullore të miratuar nga Komuna përkatëse.

Neni 49 **Të drejtat e kontributdhënësve në sport**

1. Sportistët, trajnerët dhe punëtorët sportiv të cilët kanë ofruar kontributin e tyre në fushën e sportit gjatë periudhës së okupimit të Kosovës nga data 23 mars 1989 deri më 11 qershor 1999 kanë të drejtë të kompensohen për kontributin e tyre në sport.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës me propozim të Ministrisë përgjegjëse për Sport nxjerr akt nënligjor që përcakton kriteret, kushtet, procedurën dhe autoritetin vendimmarrës për zbatimin e paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 50 **Parandalimi i konfliktit të interesit dhe ndalimi i financimit të dyfishtë**

1. Personat që janë pjesë e organizatave të sportit në çfarëdo forme, nuk mund të marrin pjesë në procedurat administrative të vendimmarrjes për financim të sportit në kuadër të mekanizmave institucionale.
2. Për çështje të njejtë ndalohet financimi i dyfishtë nga burime të ndryshme të financimit sipas nenit 45 të këtij ligji.

Neni 51 **Raportimi financiar dhe auditimi**

Organizatat e sportit, federatat sportive, klubet sportive dhe federatat dhe shoqatat shumësportive janë të detyruara të përgatisin raporte vjetore financiare dhe të zhvillojnë auditime të rregullta vjetore nga auditorë të certifikuar. Raportet financiare dhe raportet e auditimit publikohen në faqet e tyre zyrtare.

Neni 52 **Mbikëqyrja e shpenzimeve të buxhetit**

1. Mbikëqyrja e shpenzimit të buxhetit për sport të Republikës së Kosovës bëhet nga Agjencia e Sportit si dhe nga komunat për pjesën e fondeve publike.
2. Agjencia e Sportit dhe Komuna mbikëqyrjen sipas paragrafit 1 të këtij neni e kryejnë në bazë të dokumentacionit dhe informatave të cilat ofrohen nga përfituesi.

3. Agjencia e Sportit dhe Komuna për zbatimin e mbikëqyrjes mund të angazhojnë auditorë përkatës.
4. Për mbikëqyrjen e kryer Agjencia e Sportit dhe Komuna hartojnë raporte të cilat i dërgohen përfituesit.
5. Në bazë të raportit për mbikëqyrjen e kryer, Agjencia e Sportit dhe Komuna mund të urdhërojnë eliminimin e parregullsive dhe kthimin e fondeve të caktuara publike.

Neni 53 **Çmimet sportive**

Ministri përgjegjës për Sport ndan çmime sportive në përputhje me nenin 39 të këtij ligji. Llojet e këtyre çmimeve, kushtet dhe procedura përkatëse, përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministri përgjegjës për Sport.

Neni 54 **Çmimet e ndara nga organizatat e sportit dhe komunat**

Organizatat e sportit dhe komunat kanë të drejtë që përmes akteve të tyre të brendshme të ndajnë çmime vjetore dhe çmime të tjera të ndryshme për sportistët.

KAPITULLI VIII **INFRASTRUKTURA SPORTIVE**

Neni 55 **Infrastruktura sportive**

1. Infrastruktura sportive nënkupton një apo disa ndërtesa dhe zona sipërfaqësore të rregulluara, të zhvilluara si të vecanta apo të kombinuara, gjithënjë të pajisura me pajisje sportive përkatëse, në të cilën zhvillohen aktivitetet sportive dhe që i plotëson kushtet e përgjithshme të përcaktuara sipas legjislacionit të ndërtimit, planifikimit hapësinor dhe këtij ligji.
2. Infrastruktura sportive ndahet në infrastrukturë të veçantë sportive dhe infrastrukturë të përgjithme sportive. Kategoritë, nënkategoritë dhe llojet e infrastrukturës sportive përcaktohen me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria përgjegjëse për Sport.
3. Infrastruktura sportive mund të jetë në pronësi publike, private, dhe e kombinuar publiko-private.
4. Infrastruktura sportive përfshinë të gjitha përmbajtjet sportive, pavarësisht nëse është e përhershme apo e përkohshme. Infrastruktura sportive gjithashtu mund të përfshijë rrugë, terrene, objekte, apo sipërfaqe të tjera, të cilat rregullisht përdoren për qëllime të tjera, por në të cilat lejohet gjithashtu zhvillimi i aktivitetit sportiv sipas lejes së autoritetit kompetent që menaxhon atë infrastrukturë.
5. Institucionet e Kosovës, mbi bazën e marrëveshjes së caktuar, mund të shfrytëzojnë infrastrukturën sportive private për nevoja të zhvillimit të garave të caktuara me rëndësi për vendin.

Neni 56 **Standardet dhe dimensionet**

Federatat sportive me leje për zhvillimin e veprimtarisë së tyre, ndjekin rregullat dhe standardet ndërkombëtare për kategorizimin dhe zhvillimin e infrastrukturës sportive të miratuara nga federatat ndërkombëtare përkatëse. Rregullat dhe standardet ndërkombëtare të ndërlidhura me infrastrukturën sportive bëhen publike në faqen zyrtare të federatës përkatëse.

Neni 57 **Planifikimi dhe investimet në infrastrukturën sportive**

1. Infrastruktura sportive planifikohet, zhvillohet dhe ndërtohet përmes investimeve publike, private dhe përmes partneriteteve përkatëse.

2. Financimi i ndërtimit të infrastrukturës së vecantë e cila duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara sipas legjislacionit të planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe sipas këtij ligji, bien në kompetencën e institucioneve të nivelit qendror. Ministria përgjegjëse për Sport mund të planifikoj dhe mbështes gjithashtu zhvillimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së përgjithshme.

3. Niveli lokal është përgjegjës për financimin e ndërtimit të infrastrukturës së përgjithshme sportive.

4. Ndërtimi i infrastrukturës sportive sipas partneritetit publiko-privat bëhet sipas procedurave të përcaktuara me ligjin përkatës për partneritetin publiko-privat.

5. Modalitetet, rregullat dhe procedurat për planifikimin dhe investimin në infrastrukturë sportive si dhe përcaktimi i nënkategorive sipas nenit 55 të këtij ligji përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga ministri përgjegjës për sport.

Neni 58

Ridestnimi ose rrënimi i infrastrukturës sportive

1. Komuna infrastrukturën sportive mund ta rrënojë ose ta ridestinojë mbi bazën e opinionit paraprak të Ministrisë përgjegjëse për Sport.

2. Opinioni paraprak nga paragrafi 1 i këtij neni do të jepet nëse:

2.1. infrastruktura ekzistuese nuk plotëson nevojat dhe kushtet e sigurisë për zhvillimin e aktivitetit sportive

2.2. komuna përkatëse ka planifikuar një zonë të përshtatshme zëvendësuese për infrastrukturë sportive;

2.3. nëse investitori merr përsipër përmes kontratës administrative rindërtimin e infrastrukturës sportive.

3. Me përjashtim të paragrafit 2 të këtij neni, për rrënimin e infrastrukturës së specializuar vendos Ministria pasi bën vlerësimin mbi bazën e Strategjisë së Sportit dhe dokumenteve të planifikimit dhe nëse rezulton se nuk ka më nevojë për një objekt apo sipërfaqe të caktuar, në mungesë të përdoruesve të atij objekti. Konstatimi sipas këtij paragrafi bëhet nga një komision i emëruar nga ministri përgjegjës për sport, me përfaqësues të Ministrisë, Komitetit Olimpik dhe Komunës në të cilën gjendet infrastruktura përkatëse sportive.

4. Rrënimi i infrastrukturës sportive mund të bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe legjislacionin përkatës për planifikimin hapësinor dhe pas paraqitjes së dëshmisë për planifikimin e ndërtimit të objektit zëvendësues sportiv publik si dhe paraqitjes së planit të menaxhimit.

Neni 59

Menaxhimi i Infrastrukturës Sportive dhe Bashkëpunimi Ndërkomunal

1. Menaxhimi i infrastrukturës së vecantë sportive në pronësi shtetërore bëhet nga Ministria përgjegjëse për Sport. Menaxhimi mund t'i besohet me kontratë një apo disa entiteteve të regjistruara për menaxhimin e sipërfaqeve apo objekteve sportive.

2. Menaxhimi i infrastrukturës së përgjithshme në pronësi shtetërore bëhet nga Komuna. Menaxhimi mund t'i besohet me kontratë një apo disa entiteteve të regjistruara për menaxhimin e sipërfaqeve apo objekteve sportive.

3. Dy apo më shumë komuna mund të hyjnë në bashkëpunim ndërkomunal në përputhje me ligjin përkatës për realizimin e investimeve, menaxhimin e infrastrukturës si dhe aspekte të tjera të bashkëpunimit në fushën e sportit.

4. Infrastruktura sportive e cila gjendet në kuadër të institucioneve arsimore publike mund të shfrytëzohet nga federatat dhe klubet sportive të komunës në të cilën gjendet infrastruktura e tillë. Kjo infrastrukturë menaxhohet nga institucioni përkatës arsimor në kuptim të zbatimit të kurrikulës arsimore dhe sportit shkollor ose universitar, mirëpo gjatë kohës kur nuk është në shfrytëzim nga institucionet arsimore ajo menaxhohet në përputhje me aktet nënligjore të komunës përkatëse.

5. Modalitetet, rregullat dhe procedurat për menaxhimin e infrastrukturë sportive të të gjitha niveleve përcaktohen me aktin nënligjor sipas nenit 55 të këtij ligji.

KAPITULLI IX

REGJISTRI SHTETËROR I SPORTIT

Neni 60

Regjistri Shtetëror i Sportit

1. Me qëllim të monitorimit sistematik të sektorit të sportit dhe zhvillimit afatgjatë të tij, Agjencia e Sportit krijon dhe menaxhon Regjistrin Shtetëror të Sportit (Regjistri).

2. Regjistri është një sistem i përbërë nga një grup regjistrash të ndërlidhur, të cilat mbahen nga organizatat sportive, federatat sportive dhe federatat e shoqatat shumësportive.

3. Në Regjistër përfshihen të dhënat e:

3.1. personave fizikë dhe juridikë nga neni 7 që marrin pjesë në veprimtari sportive në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj;

3.2. garave sportive të organizuara dhe rezultateve përkatëse;

3.3. financimit të sportit;

3.4. institucioneve edukativo-arsimore që ushtrojnë aktivitetin e mësimi sportiv përfshirë të dhënat e personave që ndjekin këtë aktivitet;

3.5. infrastrukturës sportive, përfshirë planifikimet për to, planet e menaxhimit, kontratat për menaxhim dhe ato për shfrytëzimin e tyre;

3.6. inspektimeve sportive të zhvilluara dhe masave përkatëse të ndërmarra;

3.7. raportet përkatëse financiare dhe ato të auditimit;

3.8. të dhënat e tjera relevante për funksionimin dhe zhvillimin e sportit në Kosovë.

4. Mekanizmat institucionalë dhe personat juridikë që marrin pjesë në veprimtari sportive sipas këtij ligji, bazuar në kompetencat dhe autorizimet e tyre, janë të detyruar të përfshijnë të dhënat përkatëse nga paragrafi 3 i këtij neni dhe të bëjnë përditësimin e tyre në Regjistër.

5. Të dhënat e përfshira në Regjistër mund të vihen në dispozicion të publikut në formën e një grupi të dhënash të hapura ose përmes një sistemi raportimi në një formë të hapur dhe të lexueshme me qëllim primar krijimin dhe përmirësimin e Strategjisë së Sportit.

6. Regjistri mund të ndërlidhet me sisteme dhe platforma të tjera ekzistuese shtetërore.

7. Mënyra e përfshirjes së të dhënave, qasjes në Regjistër dhe aspektet e tjera teknike të tij rregullohen me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria sipas propozimit të Ministrisë përgjegjëse për Sport.

KAPITULLI X E DREJTA E TRANSMETIMIT DHE REKLAMAT

Neni 61

Transmetimi i ngjarjeve sportive dhe të drejtat e transmetimit

1. Transmetimi i ngjarjeve dhe aktiviteteve sportive bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës për transmetimet mediale audiovizive.
2. Organizatorët e aktiviteteve sportive janë pronarë të së drejtës së transmetimit të asaj ngjarjeje. Ata mund ta shesin këtë të drejtë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës në bazë të një procesi transparent dhe të konkurrimit. Kontratat e tilla bëhen publike në faqen zyrtare të organizatës apo federatës përkatëse.
3. Marrëdhëniet juridike si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë me operatorët e transmetimit përcaktohen në kontratat e veçanta që lidhen ndërmjet palëve.

Neni 62 Reklamimi

1. Organizatorët e ngjarjeve apo aktiviteteve sportive gëzojnë të drejtën të përdorin sipërfaqet e dukshme të mjediseve sportive, ku ata zhvillojnë aktivitetin sportiv, për qëllime reklamimi ose sponsorizimi me personat fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, në bazë të marrëveshjeve kontraktuese të lidhura me ta.
2. Ndalohet reklamimi i produkteve dhe shërbimeve që janë në kundërshtim me qëllimin e sportit, rendin juridik dhe rregullat e moralit publik.

KAPITULLI XI DREJTËSIA SPORTIVE

Neni 63

Mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave në kuadër të federatave

1. Federatat sportive përmes akteve normative të tyre përcaktojnë rregullat, procedurat dhe mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave dhe ndërmarrjen e masave disiplinore në rast të shkeljes së akteve normative përkatëse.
2. Organet disiplinore në kuadër të federatave shqyrtojnë dhe vendosin masa disiplinore dhe ndëshkuese ndaj pjesëmarrësve në veprimtaritë, garat sportive që kryejnë shkelje disiplinore ose teknike, të cilat veprime bien ndesh me rregullat e federatës.
3. Vendimet e organeve disiplinore të federatave mund të ankimohen në mekanizmat për zgjidhjen e ankesave, të cilat krijohen dhe funksionojnë në kuadër të çdo federate përkatëse sportive në përputhje me aktet normative të tyre. Këta mekanizma zgjidhen nga kuvendi i federatës përkatëse sportive dhe i përgjigjen atij.

Neni 64 Këshilli i Arbitrazhit Sportiv

1. Në kuadër të KOK funksionon zgjidhja e mosmarrëveshjeve përmes arbitrazhit sportiv që organizohet si trupë e pavarur profesionale.
2. Në kuadër të Këshillit të Arbitrazhit Sportiv vepron edhe Gjykata e Arbitrazhit Sportiv.
3. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv është organ kolegjal që drejton, autorizon dhe kryen mbikëqyrjen e përgjithshme të punës së Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv është tribunal i formuar enkas për çdo mosmarrëveshje që zgjidhet përmes arbitrazhit dhe që përbëhet nga anëtarët e përzgjedhur nga lista e arbitrave dhe ndërmjetësve.

4. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv ka detyrën kryesore të ruaj pavarësinë e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv dhe të drejtat e palëve. Për këtë qëllim, Këshilli i Arbitrazhit Sportiv kujdeset për administrimin dhe financimin e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv do të ketë kodin e veçantë buxhetor në kuadër të KOK.

Neni 65

Përbërja, mandati dhe kushtet për tu zgjedhur anëtar

1. Përbërja e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv përcaktohet me aktin normativ nga Asambleja e Përgjithshme e KOK.

2. Anëtarët e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv i zgjedh Asambleja e Përgjithshme e KOK për një mandat pesë (5) vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

3. Kandidati për t'u zgjedhur anëtar në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv duhet ti plotësoj kriteret si në vijim:

3.1. të jetë shtetas i Kosovës dhe të jetë i dëshmuar për etikën profesionale, drejtësinë, paanshmërinë dhe përgjegjshmërinë;

3.2. të jetë jurist me së paku dhjetë (10) vite të përvojës së punës profesionale;

3.3. të ketë përvojë dhe njohuri për sportin kosovar përfshirë legjislacionin e fushës së sportit dhe legjislacionin e ndërlidhur me këtë fushë.

4. Anëtarët e Këshillit të Arbitrazhit nuk mund të jenë pjesë në listën e arbitrave ose ndërmjetësve të Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv dhe as nuk mund të jenë avokatë ose përfaqësues të palëve në procedurë pranë Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv.

5. Anëtarët e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv kanë të drejtën e kompensimit financiar për ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Mjetet për punën dhe veprimtarinë e Këshillit të Arbitrazhit dhe Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv sigurohen nga të hyrat për shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve si dhe nga buxheti i KOK.

6. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv dhe Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv, procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe kompensimi për punën e tyre përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e KOK sipas propozimit të Këshillit të Arbitrazhit Sportiv.

Neni 66

Gjykata e Arbitrazhit Sportiv

1. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv funksionon në kuadër të Këshillit të Arbitrazhit Sportiv dhe është përgjegjëse për zgjidhjen e kontesteve dhe mosmarrëveshjeve në fushën e sportit dhe antidopingut.

2. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv vendos për kontestet në fushën e sportit ndaj KOK, KPK, federatave përkatëse të sportit, të klubeve sportive, federatave e shoqatave shumë sportive, dhe personave tjerë fizik dhe juridik të përfshirë në sistemin e sportit, për të cilat konteste janë shtjerrë ose nuk ekzistojnë mjete të tjera të mbrojtjes juridike në kuadër të procedurave të brendshme të atyre organizatave dhe nëse ekziston një marrëveshje mes palëve që mosmarrëveshja e tyre të zgjidhet përmes arbitrazhit sportiv në KAS. Marrëveshja në mes të palëve që mosmarrëveshja e tyre të zgjidhet përmes arbitrazhit sportiv në KAS mund të jetë si klauzolë arbitrazhi në marrëveshje ekzistuese nga e cila buron mosmarrëveshja, një marrëveshje e lidhur në mes të palëve pasi që ka lindur mosmarrëveshja, apo si detyrim për palët që buron nga rregullativa e brendshme e organizatës.

3. Vendimet e GjAS janë të formës së prerë dhe të ekzekutueshme ndaj palëve në arbitrazh.

4. Për moszbatimin e Vendimit të GjAS nga palët në arbitrazh, Agjencia e Sportit dhe Inspektorati i Sportit ndërmarrin masa dhe sanksione përkatëse ndaj palës moszbatuese ashtu si të parapara me këtë ligj.

5. Për moszbatimin e Vendimit të GjAS nga palët në arbitrazh respektivisht nga anëtarët në kuadër të Federatës, Federata dhe Inspektorati ndërmarrin masa dhe sanksione përkatëse të përcaktuara me aktet normative të Federatës dhe dispozitat përkatëse të këtij ligji.

Neni 67

Numri i arbitrave dhe ndërmjetësve si dhe kushtet për tu zgjedhur arbitër dhe ndërmjetës

1. Numri i arbitrave dhe ndërmjetësve të Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv përcaktohet me akt normativ nga Asambleja e Përgjithshme e Komitetit Olimpik.

2. Arbitrat dhe ndërmjetësit e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme e Komitetit Olimpik.

3. Kandidati për t'u zgjedhur arbitër ose ndërmjetës, duhet të plotësoj kriteret si në vijim:

3.1. të jetë shtetas i Kosovës dhe të jetë i dëshmuar për etikën profesionale, drejtësinë, paanshmërinë dhe përgjegjshmërinë;

3.2. të jetë jurist me së paku dhjetë (10) vite të përvojës së punës profesionale;

3.3. të ketë përvojë dhe njohuri për sportin kosovar përfshirë legjislacionin e fushës së sportit dhe legjislacionin e ndërlidhur me këtë fushë;

3.4. Ndërmjetësit nga ky nen duhet të jenë të certifikuar sipas Ligjit përkatës për Ndërmjetësim.

4. Një numër i kufizuar i arbitrave dhe ndërmjetësve mund të rezervohet për ekonomistë që përshtatshmërisht i plotësojnë kushtet nga nën-paragrafi 3.1 dhe 3.2 i këtij neni, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme e KOK.

5. Detyrat dhe përgjegjësitë e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e arbitrave dhe ndërmjetësve, procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe kompensimi për punën e tyre përcaktohen me akt nënligjor sipas paragrafit 6 të nenit 65 të këtij ligji.

KAPITULLI XII PAPAJTUESHMËRIA

Neni 68 Papajtueshmëria

1. Asnjë person me vendim të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale, përveç atyre nga pakujdesia, apo i pezulluar nga Gjykata sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale nuk mund të kryejë punë profesionale në sport, nuk mund të jetë pjesë e organeve drejtuese të organizatave sportive, federatave sportive, klubeve sportive apo federatave ose shoqatave shumë sportive, si dhe nuk mund të jetë pjesë e mekanizmave institucionalë të përcaktuara me këtë ligj. I njeiti person nuk do të ketë qasje në ambientet e organizates, nuk do të ketë të drejtë të ndërmarrë detyrë zyrtare dhe do të përmbahet nga kontakti me punonjësit në zyrën/ambientin sportiv. Ky rregull aplikohet edhe në rastet e kandidimit apo përzgjedhjes në funksionet e lartpërmendura.

2. Personi juridik që merr pjesë në sport, gjegjësisht mekanizmi institucional përkatës për pjesën që është kompetent, brenda afatit prej tre (3) ditë pasi të ketë rënë në dijeni për dënimin e formës së prerë sipas paragrafit 1 të këtij neni është i detyruar ta përjashtojë personin nga përfshirja e mëtutjeshme në veprimtari sportive, duke bërë çregjistrimin, shkëputur kontratën apo ndërmarrë çdo veprim tjetër për ndërprerjen e aktivitetit.

3. Nëse personi juridik që merr pjesë në veprimtari sportive kupton që ndaj një personi pjesëmarrës në veprimtari sportive është iniciuar rasti për vepër penale ndaj fëmijës, menjëherë do ta pezullojë atë nga çfarëdo veprimtarie që mund ta sjellë në kontakt me fëmijët, deri në vendimin e plotfuqishëm të gjykatës.

Neni 69

Papajtueshmëria në ushtrimin e funksioneve në kuadër të sportit të njejtë

1. Një person fizik mund të autorizohet të përfaqësojë, të menaxhojë punët, të jetë anëtar i bordit ose organit drejtues apo të ushtrojë pozitën e drejtorit ekzekutiv vetëm në një klub sportiv të sportit të njëjtë.

2. Një person nuk mund të autorizohet të përfaqësojë, të menaxhojë punët, të jetë anëtar i bordit ose organit drejtues apo të ushtrojë pozitën e drejtorit ekzekutiv nëse është:

- 2.1. i dënuar për vepër penale sipas nenit 68;
- 2.2. sportist profesional;
- 2.3. agjent sportiv; ose
- 2.4. anëtar i personit juridik që merret me aktivitete të organizimit sportiv.

Neni 70

Kundërvajtjet

1. Me gjobë nga njëmijë (1,000) euro deri në pesë mijë (5,000) euro gjobitet personi juridik i cili merr pjesë në aktivitet sportiv në rast se:

- 1.1. organizon garë sportive të sportit të organizuar për të cilën nuk është kompetent;
- 1.2. nënshkruan kontratë me sportistin në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në këtë ligj që rregullojnë kontratën;
- 1.3. lejon pjesëmarrjen në garë sportive të personit të cilit nuk i është vërtetuar aftësia në bazë të kontrollit shëndetësor;
- 1.4. veprimtarinë sportive e zhvillon në një ambient i cili është i rrezikshëm për shëndetin dhe mirëqenien e sportistëve apo personave të tjerë të përfshirë në aktivitet sportiv;
- 1.5. nuk ofron sigurinë e nevojshme gjatë garës sportive ose stafin mjekësor përkatës;
- 1.6. nuk dërgon me kohë dhe sipas aktit nënligjor përkatës të dhënat përkatëse në Regjistrin Shtetëror të Sportit;
- 1.7. lejon ushtrimin e veprimtarisë sportive të sportistit, personit që kryen punë profesionale në sport ose personave të tjerë pa u regjistruar dhe plotësuar kushtet sipas dispozitave të këtij ligji;
- 1.8. lejon ushtrimin e veprimtarisë sportive të personit i cili ka papajtueshmëri për të bërë një gjë të tillë në bazë të neneve 68 dhe 69 të këtij ligji;
- 1.9. nuk përmbush obligimet e planifikimit, raportimit, auditimit dhe publikimit të akteve e raporteve përkatëse, të kërkuara sipas dispozitave të këtij ligji; ose
- 1.10. nuk përmbush rekomandimet e Inspektoratit të Sportit për shmangien e mospërputhshmërisë ligjore të konstatuar.

2. Personat juridikë dhe personat fizikë që marrin pjesë në veprimtari sportive, të cilat veprojnë në baza diskriminuese gjobiten sipas ligjit përkatës për mbrojtje nga diskriminimi.

3. Me gjobë nga pesëqind (500) euro deri në një mijë e pesëqind (1500) euro gjobitet personi fizik si pjesëmarrës në aktivitet sportiv në rast se:

- 3.1. ushtron punë profesionale në sport, pa përmbushur kushtet e përcaktuara sipas këtij ligji;
- 3.2. detyron sportistin të trajnohet në masën që rrezikon shëndetin dhe mirëqenien e sportistit,
- 3.3. përdor preparate stimuluese të cilat janë të ndaluara; ose
- 3.4. detyron sportistin të marrë pjesë në garë sportive pavarësisht lëndimit të tij të vërtetuar nga stafi mjekësor.

Neni 71 **Dispozitat kalimtare**

1. Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji hartohen dhe miratohen jo më larg se gjashtë (6) muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore sipas paragrafit 1 të këtij neni vlejnë dispozitat e akteve nënligjore të nxjerra sipas Ligjit nr. 2003/24 të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075 dhe Ligjin nr. 06/L-115 përderisa të njëjtat nuk bien ndesh me dispozitat përkatëse të këtij ligji.
3. Procedurat e filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji zbatohen sipas dispozitave të përkatëse të legjislacionit në fuqi kur është iniciuar procedura, me përjashtim të federatave sportive të cilave u skadon afati i licencës, të njëjtave u njihet licenca deri në nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse që nderlidhen me procesin e lejimit të zhvillimit të veprimtarisë sportive.

Neni 72 **Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Inspektimet**

1. Në paragrafin 1 të Shtojcës së Ligjit nr. 08/L-067 për Inspektimet, pas nënparagrafit 1.8, shtohet nënparagraf i ri me tekstin në vijim:

1.9. Inspektorati Qendror i Sportit, në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për Sport, është përgjegjës për inspektimet në fushën e sportit.

Neni 73 **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji nr. 2003/24, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075 dhe Ligjin nr. 06/L-115.

Neni 74 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-277
11 korrik 2024

Ligji shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.